



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 104, datë 23.05.2023

PËR

**“RENDITJEN E KANDIDATËVE PËR POZICIONIN VAKANT TË
DREJTUESIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË
PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 47 pika 6 dhe 52 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 27 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, miratuar me vendimin nr. 200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VËREN:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 127, datë 02.06.2022, ka shpallur vendin vakant për Drejtues prokurorie në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, referuar ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Rregullores së Këshillit “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me vendimin nr. 200, datë 23.09.2020 (në vijim Rregullorja).
2. Në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë më datë 06.06.2022 janë njoftuar të dhënat lidhur me subjektet që kanë të drejtë të kandidojnë, kushtet ligjore, afati deri kur pranohen aplikimet etj. Pas përfundimit të afateve të aplikimit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës filloi punën me verifikimin paraprak të plotësisimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve.
3. Për pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, rezultuan 6 kandidatë si më poshtë:
 - a. Çlirim Sino, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (aktualisht i pezulluar).
 - b. Elida Hoxhaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
 - c. Elion Mustafaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.



- d. Ervisa Hyka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
 - e. Genci Mane, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (*aktualisht Drejtues i caktuar për kohësisht në këtë Prokurori*).
 - f. Suela Beluli, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
4. Në zbatim të ligjit dhe rregullores përkatëse, kjo procedurë ka kaluar në 3 etapa:
- a. Verifikimi i përmbushjes së kushteve ligjore të kandidimit.
 - b. Verifikimi i pasurisë dhe figurës.
 - c. Vlerësimi krahasimor i kriterëve të posaçme për secilin kandidat që ka kaluar dy fazat e para.

A. Verifikimi i përmbushjes së kushteve ligjore të kandidimit

5. Në fazën e parë pas verifikimit të plotësisë të kushteve ligjore për secilin kandidat, Këshilli i Lartë të Prokurorisë me vendimin nr. 152, datë 27.06.2022, miratoi listën e kandidatëve, ku rezultoi se të 6 kandidatët në garë plotësonin kushtet ligjore të kandidimit, duke u kualifikuar në fazën e dytë të procedurës së ngritjes në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

B. Verifikimi i pasurisë dhe figurës

6. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, bazuar në vendimin e Këshillit nr. 161, datë 05.07.2022, filloi procedurën administrative për verifikimin e pasurisë dhe figurës për të gjashtë kandidatët që cilët përmbushnin kushtet ligjore të kandidimit, nga ku rezultoi se:
7. Për kandidatin **Çlirim Sino**, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. 223, datë 27.07.2022, ka vendosur ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës, për shkak të shkarkimit të tij nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 547, datë 06.07.2022. Për këtë shkak Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. 99, datë 09.05.2023, ka vendosur ndër të tjera, të përfundojë procedurën e ngritjes në detyrën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të juridiksionit të Përgjithshëm Fier për këtë kandidat.
8. Për kandidaten **Ervisa Hyka**, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 47, datë 23.02.2023 "**Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës**", ka vendosur:
- a. *të vlerësojë të përfunduar procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit Ervisa Hyka, kandidat për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier,*
 - b. *lejimin e kandidatit prokuror Ervisa Hyka të vijojë me procedurën e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.*
9. Megjithatë kandidatja Ervisa Hyka, nëpërmjet e-mail dërguar më datë 11.04.2023, bazuar në pikën 8 të nenit 20 të rregullores, **është tërhequr nga gara për këtë procedurë**. Për këtë shkak, nuk u vijua më tej me vlerësimin e kriterëve të tjera të fazës së tretë.

10. Për kandidatën **Elida Hoxhaj**, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 6, datë 16.01.2023 “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës” ka vendosur:
- të vlerësojë të përfunduar procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit Elida Hoxhaj, kandidat për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier*
 - lejimin e kandidatit prokuror Elida Hoxhaj të vijojë me procedurën e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.*
11. Për kandidatin **Elion Mustafaj**, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 7, datë 16.01.2023 “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës” ka vendosur:
- të vlerësojë të përfunduar procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit Elion Mustafaj, kandidat për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier,*
 - lejimin e kandidatit prokuror Elion Mustafaj të vijojë me procedurën e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.*
12. Për kandidatin **Genci Mane**, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 56, datë 06.03.2023 “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës” ka vendosur:
- të vlerësojë të përfunduar procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit Genci Mane, kandidat për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier,*
 - lejimin e kandidatit prokuror Genci Mane të vijojë me procedurën e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.*
13. Për kandidatën **Suela Beluli**, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 7, datë 16.01.2023, “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës” ka vendosur:
- të vlerësojë të përfunduar procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidates Suela Beluli, kandidate për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier,*
 - lejimin e kandidates prokuror Suela Beluli të vijojë me procedurën e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.*
14. Në përfundim të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, vijuan procedurat në zbatim të etapës së tretë për kandidatët:
- Elida Hoxhaj**, ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranë, në vitin 1991. Nga viti 1991 deri në vitin 2005 ka punuar fillimisht si hetuese e më tej si Oficere e Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Me Dekretin nr. 4523, datë 31.03.2005, të Presidentit të Republikës, Znj. Elida Hoxhaj është emëruar Prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ku ushtron detyrën edhe aktualisht. Me Vendim të KLP është caktuar përkohësisht si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për një periudhë prej rreth 1 vit e 4 muaj deri më datë 01.02.2023. Kandidatja ka ndjekur trajnime të shumta.*



- b. **Elion Mustafaj**, ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranë, në vitin 2003. Z. Mustafaj ka filluar punë në vitin 2004 si kancelar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Nga viti 2005 deri në vitin 2012 ka ushtruar detyrën si Oficer i Policisë Gjyqësore në rokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe Tiranë. Me dekretin e Presidentit të Republikës nr.7504 të datës 04.06.2012 është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë. Me dekretin e Presidentit të Republikës nr.9359 të datës 14.12.2015 është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ku dhe ka emërimin aktualisht. Gjatë karrierës së tij si prokuror ka shërbyer për periudha të ndryshme si i komanduar në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Pogradec, Njësinë e përbashkët hetimore, ndihmës ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme dhe si pjesë e grupit të punës për hartimin e raporteve të vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar në Prokurorinë e Përgjithshme. Aktualisht Z. Mustafaj është i transferuar përkohësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje ku ushtron përkohësisht detyrën e Drejtuesit të kësaj Prokurorie. Kandidati ka ndjekur “Master” në të drejtë penale në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranë si dhe trajnime të shumta.
- c. **Genci Mane**, ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranë, në vitin 1997 (sistemi pa shkëputje nga puna). Nga viti 2001 deri në vitin 2005 ka punuar si Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat. Me Dekretin nr. 4560, datë 05.05.2005, të Presidentit të Republikës, Z. Genci Mane është emëruar Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ku ushtron detyrën edhe aktualisht. Me Vendim të KLP është caktuar përkohësisht si Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë nga data 10.03.2022 e deri aktualisht.
- d. **Suela Beluli**, ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Elbasanit, në vitin 1999. Nga viti 2000 deri në vitin 2015 ka punuar si Oficere e Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Me Dekretin nr. 9125, datë 01.06.2015, të Presidentit të Republikës, Znj. Suela Beluli është emëruar Prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ku ushtron detyrën edhe aktualisht. Nga ana e prokurorit të përgjithshëm është caktuar përkohësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për rreth 11 muaj dhe me Vendim të KLP është caktuar përkohësisht si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për një periudhë prej rreth 6 muajsh. Aktualisht mbulon detyrën e Zëvendës drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Kandidatja ka ndjekur trajnime të shumta.
15. Në zbatim të pikës 1 të nenit 19, të rregullores, Këshilli hodhi shortin për caktimin e relatorit për fillimin e procedurës së ngritjes në detyrën e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
16. Me vendimin nr. 57, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për caktimin me short të Relatorit për fillimin e procedurës së ngritjes në detyrën e Drejtuesit, për kandidatët që kanë kaluar procesin e verifikimit”, është vendosur anëtarja e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, znj. Eloida Goxhi si Relatore për këtë procedurë. Ky vendim iu dërgua më datë 10.03.2023, në rrugë elektronike të gjithë kandidatëve. Nga ana e kandidatëve në rrugë elektronike u konfirmua marrja

e njoftimit, duke u shprehur se nuk kanë pretendime lidhur me Relatorin dhe nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

17. Meqenëse nuk ka pasur asnjë kërkesë për përjashtimin e relatorit, referuar nenit 23 të Rregullores, u vijua me procedurën dhe nga Njësia e Mbështetjes së Komisioneve u administrua informacioni nga dosjet personale të kandidatëve pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore që ndodhet në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

C. Vlerësimi krahasimor i kritereve të posaçme për secilin kandidat që ka kaluar të dy fazat e para

18. Bazuar në nenin 10 të rregullores, kjo procedurë ka 4 hapa:
- a. u zbatua fillimisht kriteri i nivelit të dy vlerësimeve të fundit etike dhe profesionale;
 - b. në rast të kandidatëve me nivele të barabarta vlerësimi, sipas shkronjës “a”, zbatohet skema e pikëzimit për renditjen e tyre, në bazë të kritereve përbërës të vlerësimit të posaçëm, sipas Aneksit nr. 1. Vlerësimi i Kriteret e posaçme, ku përfshihen:
 - i. *Aftësitë e organizimit në punë dhe drejtimi;*
 - ii. *Aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore;*
 - iii. *Aftësitë në ndërveprim me median;*
 - iv. *Aftësitë të tjera;*
 - v. *Vizioni për ngritjen e një zyre prokurorie funksionale dhe efektive;*
 - c. Në rast se edhe pas vlerësimit të bërë sipas germës “b” ka më shumë se një kandidat me pikë të barabarta, zbatohet kriteri i përvojës profesionale specifike, që kërkohet për pozicionin e lirë;
 - d. Në rast se edhe pas vlerësimit të bërë sipas germës “c” ka më shumë se një kandidat me nivel të barabartë vlerësimi, zbatohet kriteri i vjetërsisë si magjistrat;
19. Për zonjën **Elida Hoxhaj**, rezultoi se, në dy vlerësimet e fundit, për vitet 2015 dhe 2016 është vlerësuar **“Shumë mirë”**, që referuar nenit 31 të Rregullores, konvertohet në **“Shkëlqyeshëm”**.
20. Për zotën **Elion Mustafaj**, rezultoi se, në dy vlerësimet e fundit, për vitet 2015 dhe 2016 është vlerësuar **“Shumë mirë”**, që referuar nenit 31 të Rregullores së sipërpërmendur, konvertohet në **“Shkëlqyeshëm”**.
21. Për zotën **Genci Mane**, rezultoi se, në dy vlerësimet e fundit, për vitet 2015 dhe 2016 është vlerësuar **“Mirë”**, që referuar nenit 31 të Rregullores së sipërpërmendur, rezulton po prapë **“Mirë”**.
22. Për zonjën **Suela Beluli**, rezultoi se, në dy vlerësimet e fundit, për vitet 2015 dhe 2016 është vlerësuar **“Shumë mirë”**, që referuar nenit 31 të Rregullores, konvertohet në **“Shkëlqyeshëm”**.
23. Konstatohet se tre kandidatët, Elida Hoxhaj, Elion Mustafaj dhe Suela Beluli kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë. Kandidati i

katërt, Genci Mane ka kaluar rivlerësimin kalimtar me vendim të Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit që është ankimuar nga ana e Komisionerit Publik.

24. Kandidati Genci Mane ka kërkuar vlerësim të përshpejtuar referuar nenit 97 të ligjit nr. 96/2016 me shkresën e protokolluar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nr. 706. Prot, datë 27.03.2023. Lidhur me këtë kërkesë, nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me vendimin nr. 74, datë 24.04.2023 ka vendosur refuzimin e vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar për këtë kandidat.
25. Genci Mane rezulton se dy vlerësimet e fundit (vitet 2015 dhe 2016) i ka “Mirë”, duke bërë që për këtë kandidat referuar përcaktimeve të nenit 52 pika 10, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe neneve 10 dhe 11 të Rregullores, të mos vijohet me vlerësimin e posaçëm.
26. Vlen të theksohet fakti se edhe nëse Këshilli do të kishte pranuar kërkesën e këtij kandidat në lidhje me vlerësimin e përshpejtuar dhe eventualisht ta kishte vlerësuar maksimalisht atë, përsëri ky kandidat do të kishte nivel më të ulët vlerësimi se tre kandidatët e tjerë në garë, duke sjellë të njëjtën pasojë, mos kalimin në vlerësim të posaçëm dhe renditjen e tij si i fundit.
27. Duke qenë se 3 kandidatë në garë, Elida Hoxhaj, Elion Mustafaj dhe Suela Beluli kanë nivel të njëjtë vlerësimi, referuar nenit 10 pika 1 germa b), do të kalohet në vlerësimin e posaçëm sipas skemës së paraqitur në nenet 12, 13, 14 dhe 15 si dhe Aneksin nr.1 të Rregullores.
28. Nga ana e Relatores, me e-mail të datës 16.03.2023, me qëllim vazhdimin e procedurave të vlerësimit, ju është kërkuar kandidatëve dokumentacioni si më poshtë:
- a. *Eksperiencë e mëparshme si drejtues në sistemin e prokurorisë.*
 - b. *Eksperiencë e mëparshme në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë.*
 - c. *Hartues kryesor ose bashkë hartues i akteve ligjore.*
 - d. *Hartues kryesor ose bashkë hartues i akteve administrative.*
 - e. *Pjesëmarrje dhe këshillim në grupet e punës për hartimin e akteve ligjore.*
 - f. *Pjesëmarrje dhe këshillim në grupet e punës për hartimin e akteve administrative.*
 - g. *Eksperiencë e mëparshme si prokuror i caktuar për çështjet e shtypit.*
 - h. *Pjesëmarrje në çështje penale të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike.*
 - i. *Trajnime afatgjata jo më pak se dy javë në fushën e marrëdhënieve me publikun.*
 - j. *Trajnime afatshkurtra në fushën e marrëdhënieve me publikun.*
 - k. *Aktivizim në struktura organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit.*
 - l. *Aktivizim, si magjistrat udhëheqës për kandidatë prokurorë, si ekspert apo lehtësues në Shkollën e Magjistraturës.*
 - m. *Mbajtja e gradës shkencore ose titujve akademikë, studime dhe specializime afatgjata, zotërim i gjuhëve të huaja.*

n. *Aftësi e provuar për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore.*

29. Nga ana e kandidatëve, është sjellë dokumentacioni i kërkuar brenda afatit të përcaktuar prej 7 ditë pune.

30. Nga ana e **Znj. Elida Hoxhaj**, më datë 24.03.2023, është sjellë dokumentacioni si më poshtë:

- a. *Shkresë sqaruese;*
- b. *9 Urdhra të ndryshëm të Drejtuesit;*
- c. *Kodi Etikës;*
- d. *Udhëzim;*
- e. *Certifikatë pjesëmarrje në trajnim;*
- f. *Artikuj të ndryshëm;*
- g. *2 Raporte vjetore;*
- h. *2 vendime të KLP.*

31. Nga ana e **Z. Elion Mustafaj**, më datë 21.03.2023, është sjellë dokumentacioni si më poshtë:

- a. *Shkresë sqaruese;*
- b. *2 Urdhra të Prokurorit të Përgjithshëm;*
- c. *6 Vendim të KLP;*
- d. *Vërtetim nga Prokuroria e Përgjithshme;*
- e. *4 Udhëzime të ndryshme;*
- f. *2 Urdhra të brendshëm të Drejtuesit dhe rregullore;*
- g. *12 Urdhra të brendshëm të Drejtuesit;*
- h. *Urdhër i Prokurorit të Përgjithshëm dhe rregullore;*
- i. *Urdhër i brendshëm i Drejtuesit dhe rregullore;*
- j. *Urdhër i brendshëm i Drejtuesit për caktim prokurori për mediat;*
- k. *Materiale nga 6 procedime penale dhe artikuj të ndryshëm të nxjerra nga interneti;*
- l. *Vërtetim nga Akademia e Sigurisë;*
- m. *Trajnim në fushën e medias;*
- n. *Materiale në lidhje me pjesëmarrjen në grupe të ndryshme pune (7 grupe)*
- o. *15 Certifikata trajnimi;*
- p. *E-mail të ndryshëm;*
- q. *Axhendë trajnimesh të ndryshme;*
- r. *Diplomë masteri;*
- s. *Certifikatë pjesëmarrje;*
- t. *Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës.*

32. Nga ana e **Znj. Suella Beluli**, më datë 23.03.2023 dhe 29.03.2023, është sjellë dokumentacioni si më poshtë:

- a. *Shkresë sqaruese dhe Shkresë përcjellëse;*
- b. *10 Urdhra të ndryshëm të brendshëm të Drejtuesit;*
- c. *Vendim i Drejtuesit;*

NTRE I

- d. *Çertifikatë trajnimi;*
 - e. *E-mail të ndryshëm;*
 - f. *Artikuj të ndryshëm marrë nga interneti;*
 - g. *Axhendë trajnimesh të ndryshme;*
 - h. *Materiale nga 4 procedime penale;*
 - i. *2 dëshmi për gjuhën e huaja;*
 - j. *Çertifikatë për njohje kompjuteri;*
33. Gjithashtu në rrugë shkresore është kërkuar informacion edhe për ngarkesën në punë të 3 kandidatëve që vazhdojnë garën për këtë procedurë, z. Elida Hoxhaj, z. Elion Mustafaj, dhe znj. Suela Beluli, në raport me ngarkesën mesatare të zyrave të prokurorisë, ku ata ushtrojnë ose kanë ushtruar detyrën për tre vitet e fundit të marra së bashku (2020, 2021, 2022). Gjithashtu, për të shmangur konfliktin e interesit, duke qenë se njëri nga kandidatët mban detyrën e Drejtuesit me caktim të përkohshëm, këto të dhëna janë kërkuar të përgatiten nga Prokurori i Regjistrimit si dhe të përcillen pranë KLP-së nga Zëvendës drejtuesi i kësaj Prokurorie.
34. Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje me shkresën Nr. 1806/1, datë 23.03.2023 është dërguar informacioni në lidhje me ngarkesën në punë të kandidatëve Elion Mustafaj dhe Suela Beluli. Në shkresë referohet sa vijon :
- a. *Për vitin 2021 (periudha shtator-dhjetor) Elion Mustafaj ka hetuar 107 procedime penale nga të cilat ka përfunduar 48 procedime penale, 39 procedime penale i ka mosfilluar. Nga viti 2021 janë mbartur në vitin 2022 gjithsej 59 procedime penale.*
 - b. *Për vitin 2021 (periudha nëntor-dhjetor) Suela Beluli ka hetuar 78 procedime penale nga të cilat ka përfunduar 1 procedime penale, 10 procedime penale i ka mosfilluar. Nga viti 2021 janë mbartur në vitin 2022 gjithsej 77 procedime penale.*
 - c. *Gjatë vitit 2021 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje ka regjistruar 1439 kallëzime penale dhe 932 procedime penale.*
 - d. *Për vitin 2022 (periudha janar-dhjetor) Elion Mustafaj ka hetuar 188 procedime penale nga të cilat ka përfunduar 130 procedime penale, 24 procedime penale i ka mosfilluar.*
 - e. *Për vitin 2022 (periudha janar-prill) Suela Beluli ka hetuar 129 procedime penale nga të cilat ka përfunduar 76 procedime penale, 33 procedime penale i ka mosfilluar. Prokurore Suela Beluli në largim ka dorëzuar 53 procedime penale.*
 - f. *Gjatë vitit 2022 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje ka regjistruar 1020 kallëzime penale dhe 786 procedime penale.*
 - g. *Gjatë vitit 2021, në datë 24.09.2021 datë në të cilën është caktuar Z. Mustafaj, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje ka patur vetëm 2 prokurorë. Në datë 03.11.2021, datë në të cilën është caktuar Znj. Beluli, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje ka pasur 3 prokurorë.*
 - h. *Për shkak të dinamikës së lëvizjeve të prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje gjatë vitit 2021 dhe 2022 nuk mund të*

përlllogaritet një mesatare mbi ngarkesën e prokurorëve për shkak të diferencave në ngarkesë me prokurorët e emëruar të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, të cilët kanë mbartur procedime nga prokurorët e shkarkuar nga detyra ose të transferuar në prokurori të tjera.



35. Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me shkresën Nr. 2474, datë 29.03.2023 është dërguar informacioni në lidhje me ngarkesën në punë të kandidatëve Elida Hoxhaj dhe Suela Beluli. Në shkresë referohet sa vijon :
- Prokurore Elida Hoxhaj në periudhën 23.09.2021 – 31.01.2023 është caktuar përkohësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë dhe ka dorëzuar 162 procedime.*
 - Prokurore Suela Beluli në periudhën 03.11.2021 – 02.05.2022 është caktuar përkohësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Lushnje dhe ka dorëzuar 67 procedime dhe 12 referime pasurore.*
 - Në të dhënat e mësipërme nuk janë pasqyruar kërkesat në faze ekzekutimi dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë.*
36. Bashkë me të dhënat e dërguara, më sipër kjo prokurori ka dërguar ngarkesën e të gjithë prokurorëve.

Për vitin 2020 :

<i>Prokurori</i>	<i>totali</i>	<i>bashkuar</i>	<i>pezulluar</i>	<i>pushuar</i>	<i>transferuar</i>	<i>dërguar në gjyq</i>	<i>mos filluar</i>	<i>mbetur në hetim</i>
Elida Hoxhaj	364	1	90	45	2	74	50	102
Suela Beluli	127	4	3	21	4	18	13	64

Për vitin 2021 :

<i>Prokurori</i>	<i>totali në hetim</i>	<i>bashkuar</i>	<i>pezulluar</i>	<i>pushuar</i>	<i>transferuar</i>	<i>dërguar në gjyq</i>	<i>përfunduar</i>	<i>mbetur ne hetim</i>	<i>mos filluar</i>
<i>Elida Hoxhaj</i>	153	3	74	27	3	46	153	0	37
<i>Suela Beluli/E.Shehu</i>	55	4	17	13	2	19	55	0	19

Për vitin 2022 :

<i>Prokurori</i>	<i>mbartur në 20(+kthyer nga gjykata nga vt tj)</i>	<i>regjistruar 2022</i>	<i>rifill/shfuq/terheq</i>	<i>totali në hetim</i>	<i>bashkuar</i>	<i>pezulluar</i>	<i>pushuar</i>	<i>transferuar</i>	<i>dërguar gjyqit</i>	<i>përfunduar</i>	<i>mbetur në hetim</i>	<i>mos filluar</i>
<i>Suela Beluli</i>	13	165	1	179	4	12	8	2	21	47	132	24

37. Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me shkresën Nr.3053/1, datë 04.04.2023 është dërguar informacioni në lidhje me ngarkesën në punë të kandidatit Elion Mustafaj. Në shkresë referohet sa vijon :
- Për vitin 2020 ka marrë gjithsej 63 referime/kallëzime nga të cilat ka regjistruar si procedime penale 45 çështje. Nga këto ka përfunduar gjithsej 49 çështje (33 procedime dhe 16 mosfillime).*
 - Për vitin 2021 ka marrë gjithsej 44 referime/kallëzime nga të cilat ka regjistruar si procedime penale 37 çështje. Nga këto ka përfunduar gjithsej 11 çështje (8 procedime dhe 3 mosfillime).*
38. Bashkëlidhur shkresës, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë vënë në dispozicion edhe statistikat për të gjithë prokurorët e kësaj prokurorie por pa nxjerrë një mesatare ngarkese.
39. Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me shkresën Nr.444/1, datë 11.04.2023 është dërguar informacioni në lidhje me ngarkesën në punë të kandidatës Elida Hoxhaj për periudhën që ka qenë e caktuar përkohësisht në Apel. Në shkresë referohet sa vijon :
- Për periudhën shtator 2021 – dhjetor 2021 ka marrë pjesë në :
 - 51 përfaqësime të akuzës për çështje themeli dhe ka ushtruar rekurs në 2 prej tyre.*
 - 55 përfaqësime për çështje penale të veçanta, ka ushtruar rekurs në 1 prej tyre.*
 - 80 përfaqësime për masat e sigurimit dhe ka nxjerrë 30 urdhra ekzekutimi për vendimet gjyqësore.*
 - Për periudhën janar 2022 – dhjetor 2022 ka marrë pjesë në :
 - 144 përfaqësime të akuzës për çështje themeli dhe ka ushtruar rekurs në 8 prej tyre.*



- ii. 192 përfaqësime për çështje penale të veçanta, ka ushtruar rekurs në 1 prej tyre.
 - iii. 256 përfaqësime për masat e sigurimit dhe ka nxjerrë 103 urdhra ekzekutimi për vendimet gjyqësore.
40. Mbas mbylljes së afatit të plotësimit të dokumentacionit, është ka kaluar në fazën e vlerësimit të dokumentacionit për secilin kandidat duke bërë edhe vlerësimin e posaçëm referuar nenit 13 dhe 14 të Rregullores.
41. Konkretisht mënyra e vendosjes së shkallës së vlerësimit të kriterëve të posaçme përcaktohet në nenin 15 “Niveli dhe pikëzimi” të Rregullores, si më poshtë:
- a. Në zbatim të kësaj rregulloreje, vlerësimi i posaçëm i kandidatëve do të bëhet me nivele vlerësimi dhe pikëzimi.
 - b. Për nevoja vlerësimi do të zbatohen tre nivele vlerësimi, i lartë, i mesëm dhe i ulët.
 - c. Kandidati do të ketë vlerësim të lartë për kriterin përkatës nëse përmbush të paktën tre nga nën kriteret përkatëse, do të ketë vlerësim të mesëm nëse përmbush dy nën kriteret dhe do të ketë vlerësim të ulët nëse përmbush një ose asnjë nën kriter.
 - d. Për nivelin e vlerësimit të lartë do të aplikohen nga 8 deri në 10 pikë, për nivelin e vlerësimit të mesëm do të aplikohen nga 4 deri në 7 pikë dhe për nivelin e vlerësimit të ulët do të aplikohen nga 0 deri në 3 pikë, sipas Aneksit nr.1.

D. Vlerësimi i dokumentacionit për secilin kandidat

a. Vlerësimi i kriterëve për zonjën Elida Hoxhaj

1. Kriteri parë “Aftësitë e organizimit në punë dhe drejtimi”

42. Sa i takon kriterit të parë “Aftësitë e organizimit në punë dhe drejtimi”, rezulton se kandidati përmbush 2 nga nën kriteret.
- a. **Nën kriteri 1. Eksperiencë e mëparshme si drejtues në sistemin e prokurorisë.** Me Urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë nr. 16 prot. Dt. 22.02.2017 “Për krijimin e Seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”, rezulton se Znj. Hoxhaj është emëruar në detyrën e Drejtuesit të Seksionit të Krimin Ekonomik, Financiar, Korrupsionit dhe krimin kibernetik. **Kjo përbën eksperiencë si drejtues në sistemin e prokurorisë.**
 - b. **Nën kriteri 2. Ngarkesë mbi mesatare për tre vitet e fundit të ushtrimit të funksionit.** Sipas shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier (sipër përmendur), ku është dërguar informacioni në lidhje me ngarkesën në punë të kandidatit, rezulton se kandidatja Znj. Hoxhaj për vitin 2020 ka trajtuar në total 364 çështje penale. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka trajtuar një total prej 2826 çështjesh penale dhe numri i prokurorëve në detyrë për gjatë këtij viti rezulton 13. Për vitin 2021 (periudha

YTREIT

janar - tetor) kandidatja ka trajtuar një total prej 153 çështjesh penale. Në total Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për këtë vit ka trajtuar 2742 çështje dhe numri i prokurorëve në detyrë për gjatë këtij viti rezultoi 13. Sipas shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (sipër përmendur), për periudhën shtator 2021 – dhjetor 2021 kur ka ushtruar detyrën e prokurorit të Apelit në Vlorë, rezultoi se ka marrë pjesë në : 51 përfaqësime të akuzës për çështje themeli dhe ka ushtruar rekurs në 2 prej tyre, 55 përfaqësime për çështje penale të veçanta, ka ushtruar rekurs në 1 prej tyre, 80 përfaqësime për masat e sigurimit dhe ka nxjerrë 30 urdhra ekzekutimi për vendimet gjyqësore. Për periudhën janar 2022 – dhjetor 2022, po pranë kësaj prokurorie, ka marrë pjesë në : 144 përfaqësime të akuzës për çështje themeli dhe ka ushtruar rekurs në 8 prej tyre, 192 përfaqësime për çështje penale të veçanta, ka ushtruar rekurs në 1 prej tyre, 256 përfaqësime për masat e sigurimit dhe ka nxjerrë 103 urdhra ekzekutimi për vendimet gjyqësore. **Referuar sa më sipër, ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.**

- c. **Nën kriteri 3. Eksperiencë e mëparshme në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit.** Kandidatja përmend faktin se ka qenë Zv/Drejtuese e Policisë hetimore, por pa e mbështetur me dokumentacion justifikues. Edhe mbas komunikimit, nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion justifikues. **Ky fakt bën që ky nën kriter të mos vlerësohet i përmbushur.**
- d. **Nën kriteri 4.** Nuk ka përvoja në skemën e delegimit ose si inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

43. **Për kriterin e parë kandidati vlerësohet me kualifikim të mesëm, referuar nenit 15 të Rregullores.**

2. **Kriteri i dytë. “Aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore”**

44. Sa i takon kriterit të dytë “Aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore”, rezultoi se kandidati përmbush 2 nga nën kriteret.

- a. **Nën kriteri 1.** Nuk rezultoi të ketë qenë hartues kryesor ose bashkë-hartues i akteve ligjore.
- b. **Nën kriteri 2.** Hartues kryesor ose bashkë-hartues i akteve administrative; Me Urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë nr. 44 prot, datë 03.07.2017, është caktuar si anëtare e komisionit përkatës për hartimin e Kodit të Etikës dhe paraqitjen e këtij kodi tek titullari i institucionit për miratim. Nga ana e grupit të punës është hartuar Kodi i Etikës me nr. 63 prot, datë 27.09.2017, i cili është miratuar nga drejtuesi i prokurorisë. **Sa më sipër, rezultoi bashkë-hartues i akteve administrative duke përmbushur këtë nën kriter.**
- c. **Nën kriteri 3.** Nuk rezultoi të ketë pjesëmarrje dhe këshillim në grupet e punës për hartimin e akteve ligjore.

STRENI

- d. **Nën kriteri 4.** Pjesëmarrje dhe këshillim në grupet e punës për hartimin e akteve administrative. Me Urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë nr. 44 prot, datë 03.07.2017, është caktuar si anëtare e komisionit përkatës për hartimin e Kodit të Etikës dhe paraqitjen e këtij kodi tek titullari i institucionit për miratim. Nga ana e grupit të punës është hartuar Kodi i Etikës me nr. 63 prot, datë 27.09.2017, i cili është miratuar nga drejtuesi i prokurorisë. Për të njëjtin akt të përcaktuar në nën kriterin 2, bën që të përmbushet edhe ky nën kriter.
45. Për kriterin e dytë kandidati vlerësohet me kualifikim të mesëm, referuar nenit 15 të Rregullores.

3. Kriteri i tretë “Aftësitë në ndërveprimin me median

46. Sa i takon kriterit të tretë “Aftësitë në ndërveprimin me median”, rezulton se kandidati përmbush 3 nga nën kriteret.

- a. **Nën kriteri 1.** *Ekspierencë e mëparshme si prokuror i caktuar për çështjet e shtypit.* Me Urdhrin nr. 72, datë 03.07.2019 të Drejtuesit të Prokurorisë është caktuar si prokuror i caktuar për çështjet e shtypit, detyrë të cilën e ka kryer për një periudhë kohore mbi dy vjet, deri më datë 23.09.2021. **Ky nën kriter konsiderohet i plotësuar.**
- b. **Nën kriteri 2.** *Pjesëmarrje në çështje penale të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike.* Çështje që ka tërhequr vëmendjen e publikut dhe ka të bëjë me vepra të rënda penale, është vlerësuar çështja penale në ngarkim të të pandehurit A.G (alias V.Z) për të cilin prokurorja ka përfaqësuar në gjykim kërkesat për ekstradim, e më pas për njohjen e vendimit penal të huaj. Gjithashtu ka hetuar dhe dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të tij për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, ku gjatë hetimit mbi kërkesën e bërë nga ana e prokurores së çështjes është vendosur sekuestro preventive dhe është bërë sekuestrimi i pasurive. Janë paraqitur akte të dosjes penale. *Nga ana ime si relatore është kërkuar në internet në lidhje me këtë çështje dhe është printuar një shkrim gazete ku rezulton se këto pasuri janë konfiskuar me vendim Gjykate.* Ka përfaqësuar në gjykim kërkesat për njohjen e vendimeve penale të huaja, hetim për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, sekuestrimi i pasurive të dyshuara të paligjshme etj., për shtetasin Sh.Z. **Për sa sipër, ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.** Sa i takon printimeve të sjella nga kandidatja për 3 ngjarje të tjera, rezulton se ato nuk mund të quhen çështje me impakt publik por lajme rutinë të kronikës së zezë e për rrjedhojë nuk do konsiderohen si çështje penale të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike.
- c. **Nën kriteri 3.** *Nuk ka marrë pjesë në trajnime afatgjata në fushën e marrëdhënieve me publikun.*
- d. **Nën kriteri 4.** *Trajnime afatshkurtra në fushën e marrëdhënieve me publikun.* Kandidatja ka dorëzuar kopje të certifikatës për pjesëmarrjen në trajnimin me temë “Liria e shprehjes dhe medias”, organizuar nga Shkolla e

SEKRETI

Magjistraturës dhe KIE, i zhvilluar me datë 08.10.2018 në Fier. Kandidatja ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me PAMECA V, me temë “Komunikimi efektiv me publikun dhe median”, mbajtur në datë 18-19 nëntor 2021 (në cilësinë e prokurorit të caktuar për çështjet e shtypit). **Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.**

47. Për kriterin e tretë kandidati vlerësohet me kualifikim të lartë referuar nenit 15 të Rregullores.

4. Kriteri i katërt “Aftësi të tjera”

48. Sa i takon kriterit të katërt “Aftësi të tjera”, rezulton se kandidati përmbush 1 nga nën kriteret.

a. *Nën kriteri 1. Nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton aktivizim në struktura organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit.*

b. *Nën kriteri 2. Nuk është aktivizuar si magjistrat udhëheqës për kandidatë prokurorë, si ekspert apo lehtësues në Shkollën e Magjistraturës.*

c. *Nën kriteri 3. Nuk ka gradë shkencore ose tituj akademik, studime dhe specializime afatgjata dhe nuk provon se zotëron gjuhë të huaja.*

d. *Nën kriteri 4. Aftësi e provuar për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore. Nga aktet e sjella rezulton si i tillë Urdhër për krijimin e komisionit disiplinor nr. 02, datë 14.01.2010 dhe Urdhër nr. 57, datë 20.06.2018 “Për ripërtëritjen e komisionit disiplinor për vitin 2018”. **Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.***

49. Për kriterin e katërt kandidati vlerësohet me kualifikim të ulët, referuar nenit 15 të Rregullores.

b. Vlerësimi i kriterëve për zotin Elion Mustafaj

1. Kriteri parë “Aftësitë e organizimit në punë dhe drejtimi”

50. Sa i takon kriterit të parë “Aftësitë e organizimit në punë dhe drejtimi”, rezulton se kandidati përmbush 3 nga nën kriteret.

a. *Nën kriteri 1. Eksperiencë e mëparshme si drejtues në sistemin e prokurorisë. Kandidati ka eksperiencë si Drejtuesi i caktuar përkohësisht i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë prej datë 24.09.2021 deri aktualisht. Pra, 1 vit e 6 muaj. Caktimi i parë është bërë me Vendimin nr. 267, datë 16.09.2021 “Për caktimin e përkohshëm”, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe në vazhdimësi deri aktualisht. **Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.***

b. *Nën kriteri 2. Ngarkesë mbi mesatare për tre vitet e fundit të ushtrimit të funksionit. Nga dosja personale rezulton se me Vendimin Nr. 97, datë 15.04.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurori Elion Mustafaj, për periudhën 1 vjeçare nga data 01.05.2020 deri më 30.04.2021 ka qenë me leje të papaguar. Sipas shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë*

Vlorë (*sipër përmendur*), ku është dërguar informacioni në lidhje me ngarkesën në punë të kandidatit Z. Elion Mustafaj rezulton se për vitin 2020 nga data 1 janar deri më 30 prill (*kur ka marrë lejen e pa paguar*), ka marrë gjithsej 63 referime/kallëzime nga të cilat ka regjistruar si procedime penale 45 çështje. Nga këto ka përfunduar gjithsej 49 çështje (*33 procedime dhe 16 mos fillime*). Ndërkohë që po në këtë prokurori, për vitin 2021 (*nga maji deri më shtator*) ka marrë gjithsej 44 referime/kallëzime nga të cilat ka regjistruar si procedime penale 37 çështje. Nga këto ka përfunduar gjithsej 11 çështje (*8 procedime dhe 3 mosfillime*). Sipas shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje (*sipër përmendur*), Për vitin 2021 (*periudha shtator-dhjetor, kur është transferuar përkohësisht*) Elion Mustafaj ka hetuar 107 procedime penale nga të cilat ka përfunduar 48 procedime penale, 39 procedime penale i ka mosfilluar. Nga viti 2021 janë mbartur në vitin 2022 gjithsej 59 procedime penale. Po në këtë prokurori, për vitin 2022 (*periudha janar-dhjetor*) Elion Mustafaj ka hetuar 188 procedime penale nga të cilat ka përfunduar 130 procedime penale, 24 procedime penale i ka mosfilluar. Rezultoni se nga Shtatori 2021 dhe në vijim kandidati Elion Mustafaj ka ushtruar edhe funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje. **Referuar sa më sipër, ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.**

- c. **Nën kriteri 3.** *Eksperiencë e mëparshme në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit.* Kandidati ka eksperiencë të mëparshme në pozicione drejtuese në administratën e organeve të drejtësisë, si kancelar i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për një periudhë prej 1 vit e 5 muaj, nga data 01.05.2004 deri në datën 30.09.2005 Emërimi është bërë me Urdhrin nr. 152, datë 29.04.2004, i Prokurorit të Përgjithshëm “Për caktim kuadri” dhe shkresa Nr. 1275/1 prot., datë 30.04.2004, e Sekretarit të Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Durrës. **Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.**

- d. **Nën kriteri 4.** *Nuk ka përvoja në skemën e delegimit ose si inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

51. **Për kriterin e parë kandidati vlerësohet me kualifikim të lartë, referuar nenit 15 të Rregullores.**

2. **Kriteri i dytë. “Aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore”**

52. Sa i takon kriterit të dytë “Aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore”, rezultoni se kandidati **përmbush 2 nga nën kriteret.**

- a. **Nën kriteri 1.** *Nuk rezultoni të ketë qenë hartues kryesor ose bashkë-hartues i akteve ligjore.*

- b. *Nën kriteri 2. Hartues kryesor ose bashkë-hartues i akteve administrative.*
Ka hartuar apo bashkë hartuar akte administrative, si më poshtë:
- i. Udhëzim i përgjithshëm Nr. 2, date 29.09.2021 “Për unifikimin e ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”, në kompetence të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje.
 - ii. Udhëzim i përgjithshëm Nr. 1, datë 13.09.2022 “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.
 - iii. Udhëzim i përgjithshëm Nr. 2, datë 21.12.2022 “Për marrëveshjen mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.
 - iv. Udhëzim i përgjithshëm Nr. 1, datë 02.02.2023 “Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.
 - v. “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë”, miratuar me Urdhrin e drejtuesit të prokurorisë Nr. 22, datë 20.12.2021. Në këtë rast rezulton si bashkëhartues i rregullores, vërtetuar nga Urdhri nr.12, datë 18.11.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen dhe hartimin e rregullores së brendshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje” dhe Urdhri nr.12/1, datë 26.11.2021 “Për një ndryshim në Urdhrin nr.12, datë 18.11.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen dhe hartimin e rregullores së brendshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”;
 - vi. Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 133, date 28.06.2012 “Për krijimin e grupit të punës për hartimin e projekt-aktit “Rregullore për organizimin dhe funksionin e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore”, si dhe “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë të Rretheve Gjyqësore”, miratuar me Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 176, datë 09.10.2012.
- c. 12 urdhra të brendshëm si më poshtë :
- i. Urdhër nr. 19, datë 07.12.2021 “Për lëvizjen, administrimin dhe arkivimin e dosjeve të çështjeve penale, njohjes së vendimeve penale të huaja, ekstradimeve dhe gjykimeve të çështjeve për të cilat prokurori ka ngritur padi, thirret si person i tretë, ndiqen me kërkesë në gjykatë dhe rishikimit, apo raportimet e policisë së shtetit, lidhur me veprat penale të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, që ndiqen me kërkesë në gjykatë nga viktimat akuzuese, apo për referime që dukshëm nuk përmbajnë element të ndonjë vepre penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.
 - ii. Urdhër Nr. 21, datë 15.12.2021 “Për organizimin e punës në prokurori, ndarjen e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë



- sipas prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.*
- iii. Urdhër Nr. 4, datë 21.01.2022 *“Për caktimin e prokurorit të ekzekutimeve të vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, etj, si dhe oficerit të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë dhe sekretares pranë këtij prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.*
 - iv. Urdhër Nr.8, datë 01.02.2022 *“Për organizimin e brendshëm administrative të punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.*
 - v. Urdhër Nr. 10, datë 28.02.2022 *“Për organizimin e grafikut të gatishmërisë, marrjen e masave administrative dhe procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për periudhën para dhe pas zgjedhjeve vendore për kryetar Bashkie në njësinë e Qeverisjes Vendore Bashkia Lushnje”.*
 - vi. Urdhër Nr. 17, datë 04.05.2022 *“Për caktimin e prokurorit për të ndjekur grup veprat penale kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.*
 - vii. Urdhër Nr. 24, datë 23.06.2022 *“Për raportimin periodik të treguesve të performancës dhe ngarkesës në punë të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.*
 - viii. Urdhër Nr. 28, datë 05.07.2022 *“Për ngritjen e komisionit dhe përcaktimin e procedurave të dorëzimit të dosjeve, dokumentacionit, provave dhe bazës materiale të Znj.N.P në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.*
 - ix. Urdhër Nr. 36, datë 13.09.2022 *“Për Miratimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve Prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.*
 - x. Urdhër Nr. 38, datë 28.09.2022 *“Për riorganizimin e pjesshëm të punës, caktimin/shtimin e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë për hetimin e çështjeve penale të mbartura, çështjeve penale që lidhen me zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik, trajtimin me prioritet të këtyre çështjeve, si dhe evidentimin e shkaqeve të zvarritjes së tyre, etj në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.*
 - xi. Urdhër Nr. 43, datë 21.11.2022 *“Për ngritjen e komisionit të ekspertizës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje dhe organizimin e punës së arkivit”.*
 - xii. Urdhër Nr. 4, datë 27.02.2023 *“Për ngritjen e grupit të punës për identifikimin, administrimin, dhe inventarizimin e akteve, dokumenteve regjistruar, provave materiale, bazës materiale, etj dhe arkivave të*



veprimeve procedurale penale dhe administrative të Prokurorisë pranë Gjykatës së shkallës së Parë Lushnje, si dhe dorëzimin e tyre në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier në zbatim të hartës së re gjyqësor”.

- d. ***Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.***
- e. ***Nën kriteri 3. Nuk rezulton të ketë pjesëmarrje dhe këshillim në grupet e punës për hartimin e akteve ligjore.***
- f. ***Nën kriteri 4. Pjesëmarrje dhe këshillim në grupet e punës për hartimin e akteve administrative.***
 - i. *“Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë”, miratuar me Urdhrin e drejtuesit të prokurorisë Nr. 22, datë 20.12.2021. Në këtë rast rezulton si bashkë hartues i rregullores, vërtetuar nga Urdhri nr.12, datë 18.11.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen dhe hartimin e rregullores së brendshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje” dhe Urdhri nr.12/1, datë 26.11.2021 “Për një ndryshim në Urdhrin nr.12, datë 18.11.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen dhe hartimin e rregullores së brendshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”;*
 - ii. *Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 133, date 28.06.2012 “Për krijimin e grupit të punës për hartimin e projekt-aktit “Rregullore për organizimin dhe funksionin e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore”, si dhe “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë të Rretheve Gjyqësore”, miratuar me Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 176, datë 09.10.2012.*
- g. *Aktet e përcaktuara më lart në nën kriterin 2, të cilat kanë pasur grup pune, bëjnë që edhe ky nën kriter të konsiderohet i përmbushur.*

53. ***Për kriterin e dytë kandidati vlerësohet me kualifikim të mesëm, referuar nenit 15 të Rregullores.***

3. Kriteri i tretë “Aftësitë në ndërveprimin me median

54. Sa i takon kriterit të tretë “Aftësitë në ndërveprimin me median”, rezulton se kandidati përmbush 3 nga nën kriteret.

- a. ***Nën kriteri 1. Eksperiencë e mëparshme si prokuror i caktuar për çështjet e shtypit.*** Me Urdhrin nr. 22, datë 25.05.2022 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, është caktuar si prokuror i caktuar për çështjet e shtypit ***duke plotësuar në këtë mënyrë këtë nën kriter.***
- b. ***Nën kriteri 2. Pjesëmarrje në çështje penale të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike.*** Janë paraqitur aktet e dosjes penale si dhe printime artikujsh nga gazeta të ndryshme si më poshtë:
 - i. Çështja penale Nr. 11, viti 2013, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, caktuar si prokuror me Urdhrin nr. 43, datë



- 30.01.2013, të Prokurorit të Përgjithshëm. Në përfundim të hetimeve të çështjes penale janë marrë të pandehur dhe njoftuar akuza për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, shtetasit: E. V, anëtar i KRRT-se Bashkia Pogradec, Drejtor Juridik dhe Nënkyetar i Bashkisë Pogradec. P. Z, anëtar i KRRT-se Bashkia Pogradec, Drejtor i Urbanistikës, kryetar i Këshillit Teknik dhe Nënkyetar i Bashkisë Pogradec. O. M, anëtare e KRRT-së Bashkia Pogradec dhe inspektore e Agjencisë Rajonale të Mjedisit. E. M, specialist i nivelit të lartë të Sekretariatit Teknik të KRRT-së, bashkia Pogradec.
- ii. Çështja penale Nr. 30, viti 2014, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, regjistruar për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, në ngarkim të shtetasit B.L. Kjo çështje penale ka të bëjë me vrasjen e katër personave me armë zjarri në datën 07.01.2014 në fshatin Gjonmadh, Korçë. Në përfundim të hetimeve, është deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim të përjetshëm shtetasi B.L.
- iii. Çështja penale Nr. 1800, viti 2013, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë. Kjo çështje penale ka të bëjë me arratisjen/largimi nga vendi i vuajtjes së dënimit në Institucionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale të Sigurisë së Lartë, Drenovë, Korçë, të shtatë të dënuarve me rrezikshmëri shumë të lartë shoqërore. Në përfundim të hetimeve janë proceduar penalisht dhe dërguar për gjykim 19 të pandehur, në pozicione të ndryshme të drejtimit dhe rolit bazë policinë e burgjeve të IEVP, Drenovë, për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
- iv. Çështja penale Nr. 414, viti 2016, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, bashkua më pas me çështjen nr. 266, viti 2016, regjistruar për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga nenet 186 dhe 287 të Kodit Penal. Kjo çështje penale lidhet me përvetësimin me dokumenteve të falsifikuara të 220 hektarë tokë në Gadishullin e Karaburunit, Vlorë, 89 hektarë tokë në Zvërnec, Vlorë dhe 33 hektarë tokë në Palasë, Himarë. Në lidhje me këtë sipërfaqe toke janë caktuar masa sigurimi për një notere, për përgjegjësen e arshivës së Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për 2 (dy) juristë të ZVRPP Vlorë, për një avokat, etj.
- v. Procedimi pasuror Nr. 3, viti 2021, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Ky procedim pasuror lidhet me disa pasuri të zotëruar në mënyrë të tërthortë nga shtetasi I.Z. dhe bashkëshortja e tij E.Z, si dhe të afërm të tyre. Konkretisht, bazuar në nenet 3-7, 11, 12, 14 dhe 15 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet



masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, janë sekuestruar 10 pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme.

- vi. Procedimi penal Nr. 806, viti 2021, i cili është bashkuar me procedimin penal nr. 807, viti 2021. Ky procedim penal është hetuar në dinamikë me hetime proaktive dhe aktualisht janë në hetim 11 (njëmbëdhjetë) persona, nga të cilët: 2 (dy) kryeinspektorë të IKMT-së Bashkia Lushnjë, një i larguar në momentin e caktimit të masës së sigurimit dhe një në detyrë në momentin e caktimit të masës së sigurimit, për veprën penale shpërdorimi i detyrës, parashikuara nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe 2 (dy) inspektorë të IMT Bashkia Lushnjë, për veprën penale shpërdorimi i detyrës, parashikuara nga neni 248 i Kodit Penal. Prej tyre janë lejuar 29 ndërtime pa leje gjatë vitit 2021 në territorin administrative të Bashkisë Lushnjë. 2 (dy) inspektorë policie të akuzuar për veprën penale të korrupsionit pasiv nga persona që ushtrojnë funksione publike, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259 e 25 i Kodit Penal. 2 (dy) shtetas, një prej të cilëve sipërmarrës ndërtimi dhe një shofer i punësuar prej tij, të akuzuar për veprën penale të korrupsionit aktiv të persona që ushtrojnë funksione publike, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244 e 25 i Kodit Penal. 3 (tre) shtetas për veprën penale të ndërtimit pa leje, parashikuar nga neni 199/a Kodit Penal.


- c. ***Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.***
- d. ***Nën kriteri 3. Nuk ka marrë pjesë në trajnime afatgjata në fushën e marrëdhënieve me publikun.***
- e. ***Nën kriteri 4. Trajnime afatshkurtra në fushën e marrëdhënieve me publikun. Kandidati ka dorëzuar kopje të Axhendës për trajnim të zhvilluar në kuadër të programit të përbashkët mes Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Forcimi i Efikasitetit dhe Cilësisë së Sistemit Gjyqësor në Shqipëri (SEJ II)”, me Temë: “Trajnim mbi mënyrën e zhvillimit të një marrëdhënie pozitive midis Drejtësisë dhe Medias nën Kontekstin e Reformës në Drejtësi: përdorimi i instrumenteve të CEPEJ dhe praktikave të mira të shteteve anëtare në forcimin e kësaj marrëdhënie”. Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.***

55. ***Për kriterin e tretë kandidati vlerësohet me kualifikim të lartë, referuar nenit 15 të Rregullores.***

4. Kriteri i katërt “Aftësi të tjera”

56. Sa i takon kriterit të katërt “Aftësi të tjera”, rezulton se kandidati përmbush **2 nga nën kriteret.**

- a. ***Nën kriteri 1. Aktivizim në struktura organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit.*** Sa i takon, dokumentacionit të sjellë nga kandidati në lidhje me këtë nën kriter, si më poshtë :

- 
- i. *Ka ushtruar detyrën e kancelarit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në periudhën Maj 2004–Shtator 2005, duke u angazhuar në aspektet e organizimit administrativ dhe menaxhimit financiar të institucionit.*
 - ii. Në ushtrimin e detyrës si drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, kandidati, me qëllim organizimin dhe drejtimin në mënyrë sa më efikase të veprimtarisë së punës që lidhet me Prokurorinë dhe institucione të tjera ndërvepruese, janë iniciuar nga kandidati disa takime dhe është angazhuar në disa forma të ndryshme, konkretisht si më poshtë:
 - iii. Janë hartuar dhe dërguar shkresat nr. 9626 prot., datë 17.12.2021; nr. 8484 prot., datë 19.11.2021 dhe nr. 10196 prot. (E.M.), datë 25.11.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Komisarariatit të Policisë Lushnjë dhe Komisarariatit të Policisë Divjakë. Me këto shkresa është identifikuar problematikat e konstatuara në kuadër të bashkëpunimit me shërbimet e policisë gjyqësore, si dhe kërkuar marrjen e masave përkatëse konkrete për përmirësimin e bashkëpunimit dhe efektivitetit të ndjekjes penale, etj.
 - iv. Janë iniciuar, organizuar dhe drejtuar disa takime punë për përmirësimin e veprimtarisë së punës dhe bashkëpunimit mes prokurorisë dhe institucioneve të tjera.
 - v. Në datat 07.11.2021 dhe 05.05.2021 janë zhvilluar dy takim pune me pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Lushnjë.
 - vi. Në datën 12.10.2021 është zhvilluar një takim pune me pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Divjakë.
 - vii. Në datën 02.06.2022 është zhvilluar një takim pune me prokurorët, drejtorin e Inspektoratit Rajonal të Mbrojtjes së Mjedisit Fier dhe drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier.
 - viii. Në datën 06.06.2022 është zhvilluar një takim pune me prokurorët dhe drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, Fier.
 - ix. Është hartuar dhe dërguar shkresa Nr. 10064 prot., datë 24.11.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, drejtuar drejtuesve të shërbimeve të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Komisarariatit të Policisë Lushnjë dhe Komisarariatit të Policisë Divjakë, duke i ftuar të marrin pjesë në mbledhjen e punës së organizuar në datën 01.12.2022 lidhur me drejtimit/fushat dhe veprat penale prioritare të rekomanduara në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021, etj.
- b. Nga analiza e sa më sipër, rezulton se në lidhje me detyrën e Kancelarit, ajo është një detyrë e mirëfilltë dhe jo një strukturë organizative ose model i ndryshëm drejtimi, detyrë kjo që është marrë njëherë në konsideratë tek nën



kriteri 3, i kriterit të parë. Sa i takon takimeve të organizuara si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, me institucione të ndryshme, ato konsiderohen takime në kuadër të funksionit si Drejtues i prokurorisë. **Ky nën kriter nuk do të konsiderohet i përmbushur.**

- c. **Nën kriteri 2.** *Aktivizim si magjistrat udhëheqës për kandidatë prokurorë, si ekspert apo lehtësues në Shkollën e Magjistraturës.* Dokumentacioni i sjellë në lidhje me këtë nën kriter, “Vërtetim” nr. 576 prot., datë 02.03.2023, të Akademisë së Sigurisë, Tiranë, sipas të cilit konfirmohet se kandidati ka referuar në mësimdhënie si lektor për trajnimin fillestar të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë dhe agjencive të tjera ligj zbatuese, zhvilluar gjatë periudhës 23.01.2023 – 10.02.2023. **nuk mund të konsiderohet, pasi ky nën kriter lidhet vetëm me Shkollën e Magjistraturës.**
- d. **Nën kriteri 3.** *Mbajtja e gradës shkencore ose titujve akademik, studime dhe specializime afatgjata, zotërim i gjuhëve të huaja.* Në datën 25.10.2008 ka dhënë provimin e gjuhës angleze dhe është vlerësuar me notën 9 (nëntë) nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, me Dëshminë Nr. 4848 regj., lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës. Në periudhën 2006–2008 ka ndjekur studimet pasuniversitare në Fakultetin e Drejtësisë, Departamenti i të Drejtës Penale, duke mbrojtur mikrotezën “*Trajtimi i veprave penale në fushën e veprimtarisë bankare, problematika dhe raste praktike*”, duke marrë titullin “Master” në shkencat penale. Sa i takon specializimeve të tjera të sjella nga kandidati, ato nuk mund të konsiderohen si afatgjatë, e për rrjedhojë nuk do konsiderohen. Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.
- e. **Nën kriteri 4.** *Aftësi e provuar për të punuar në grup dhe në mjedis multidisiplinare dhe/ose multikulturore.* Nga ana e kandidatit janë paraqitur Urdhra të ndryshëm për pjesëmarrje në grupe pune për hartim aktesh (të përmendura më lart) si dhe në grupe të ndryshme hetimore si prokuror dhe si O.P.GJ.
- i. Në vitin 2011, ka qenë pjesë e grupit hetimor të dy çështjeve penale me Nr. 1 dhe me Nr. 2, të Prokurorisë së Përgjithshme, regjistruar ndër të tjera për veprën penale “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. Grupi hetimor ka qenë i përbërë nga dy prokurorë dhe dy oficerë të policisë gjyqësore (*kandidati ka qenë me cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore*).
- ii. Pjesë në grupin e punës të krijuar me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 133, date 28.06.2012, i cili ka hartuar me sukses projekt-aktin “*Rregullore për organizimin dhe funksionin e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore*”, si dhe akti “*Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë të Rretheve Gjyqësore*”, e cila është miratuar me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 176, datë 09.10.2012.



- iii. Pjesë në grupin e punës të krijuar me urdhrin Nr. 12, datë 18.11.2021 i drejtuesit të Prokurorisë “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen dhe hartimin e rregullores së brendshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje” dhe urdhri Nr.12/1, datë 26.11.2021 “Për një ndryshim në urdhrin nr.12, datë 18.11.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen dhe hartimin e rregullores së brendshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”, i cili ka përgatitur me sukses “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”, miratuar me urdhrin e drejtuesit të prokurorisë Nr. 22, datë 20.12.2021.
- iv. Ka qenë pjesë e grupit hetimor ngritur me Urdhrin nr. 32, datë 08.07.2022 “Për krijimin e grupit hetimor për çështjen penale nr. 411, viti 2022”.
- v. Në vitin 2013, ka qenë pjesë e grupit hetimor të çështjes penale Nr. 1800, datë 25.11.2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, regjistruar për veprat penale “Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”.
- vi. Në vitin 2013, ka qenë pjesë e grupit hetimor të çështjes penale Nr. 11, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, regjistruar ndër të tjera për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal.
- vii. Në vitin 2016, ka qenë pjesë e grupit hetimor të çështjes penale Nr. 266, (me të cilën është bashkuar çështja penale nr. 414, viti 2016) të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, regjistruar për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga nenet 186, 248 dhe 287 të Kodit Penal. **Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.**

57. **Për kriterin e katërt kandidati vlerësohet me kualifikim të mesëm, referuar nenit 15 të Rregullores.**

c. Vlerësimi i kritereve për zonjën Suela Beluli

1. Kriteri parë “Aftësitë e organizimit në punë dhe drejtimi”

58. Sa i takon kriterit të parë “Aftësitë e organizimit në punë dhe drejtimi”, rezulton se kandidati **përmbush 2 nga nën kriteret.**

- a. **Nën kriteri 1.** Kandidatja ka 2 eksperiencë drejtuese në sistemin e prokurorisë. Kandidatja ka qenë Drejtuese e Seksionit të Veprave të Tjera në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, me Urdhrit Nr.37 datë 18.07.2022 “Për një ndryshim në Urdhrin Nr.22 datë 01.04.2022 “Për organizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier” të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Zëvendës drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier,

sipas Urdhrit Nr.38 datë 20.07.2022 të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Fier. **Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.**

- b. **Nën kriteri 2. Ngarkesë mbi mesatare për tre vitet e fundit të ushtrimit të funksionit.**
- i. Sipas shkresës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier (sipër përmendur) ku është dërguar informacioni në lidhje me ngarkesën në punë të kandidatës rezulton se kandidatja Znj. Beluli për vitin 2020 ka trajtuar në total 127 çështje penale. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka trajtuar një total prej 2826 çështjesh penale dhe numri i prokurorëve në detyrë për gjatë këtij viti rezulton 13.
 - ii. Po në të njëjtën prokurori, për vitin 2021 (periudha janar - tetor) kandidatja ka trajtuar një total prej 55 çështjesh penale. Në total Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për këtë vit ka trajtuar 2742 çështje dhe numri i prokurorëve në detyrë për gjatë këtij viti rezulton 13.
 - iii. Sipas shkresës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje (të sipër përmendur), ku kandidatja ka qenë me caktim të përkohshëm dhe është dërguar informacioni në lidhje me ngarkesën në punë të kandidatës rezulton se për vitin 2021 (periudha nëntor - dhjetor) Znj. Beluli ka hetuar 78 procedime penale nga të cilat ka përfunduar 1 procedime penale, 10 procedime penale i ka mos filluar. Nga viti 2021 janë mbartur në vitin 2022 gjithsej 77 procedime penale. Në total për këtë vit kjo prokurori ka regjistruar 1439 kallëzime penale.
 - iv. Për vitin 2022 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje (periudha janar - prill) Znj. Beluli ka hetuar 129 procedime penale nga të cilat ka përfunduar 76 procedime penale, 33 procedime penale i ka mosfilluar. Prokurore Suela Beluli në largim ka dorëzuar 53 procedime penale. Gjatë vitit 2022 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje ka regjistruar 1020 kallëzime penale
 - v. Sipas shkresës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier (sipër përmendur), me përfundimin e caktimit të përkohshëm, rezulton se për vitin 2022 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier (periudha maj - dhjetor) kandidatja Suela Beluli ka trajtuar 179 çështje penale. Në total Prokuroria e Fierit për këtë vit ka trajtuar 2822 çështje penale dhe numri i prokurorëve në detyrë për gjatë këtij viti rezulton 10.
 - vi. Në përfundim, rezulton se kandidatja, nga janari i vitit 2020 deri me shtator të vitit 2021, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka ushtruar detyrën e saj në seksionin “Kundër krimit të organizuar, trafikut të narkotikëve, korrupsionit, krimit ekonomik si dhe krimeve të kryera nga subjekte të posaçme”.
 - vii. Për periudhën që ka ushtruar funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, ka qenë prokurore e caktuar në hetimin e



veprave penale të pastrimit të produkteve penale dhe hetimeve pasurore. Gjatë vitit 2022 ku është rikthyer në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, ka ushtruar edhe funksionin e Zëvendësdrejtuesit të kësaj prokurorie.

- c. **Sa më sipër ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.**
 - d. **Nën kriteri 3. Nuk ka eksperiencë të mëparshme në pozicione drejtuese në administratën e organeve të drejtësisë.**
 - e. **Nën kriteri 4. Nuk ka përvoja në skemën e delegimit ose si inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.**
59. **Për kriterin e parë kandidati vlerësohet me kualifikim të mesëm, referuar nenit 15 të Rregullores.**

2. Kriteri i dytë. “Aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore”

60. Sa i takon kriterit të dytë “Aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore”, rezulton se kandidati **përmbush 2 nga nën kriteret.**
- a. **Nën kriteri 1. Nuk rezulton të ketë qenë hartues kryesor ose bashkë-hartues i akteve ligjore.**
 - b. **Nën kriteri 2. Hartues kryesor ose bashkë-hartues i akteve administrative.** Ka marrë pjesë në grupin e punës për përgatitjen dhe hartimin e Rregullores së Brendshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, sipas urdhrit Nr.12 datë 18.11.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Lushnjë. **Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.**
 - c. **Nën kriteri 3. Nuk rezulton të ketë pjesëmarrje dhe këshillim në grupet e punës për hartimin e akteve ligjore.**
 - d. **Nën kriteri 4. Pjesëmarrje dhe këshillim në grupet e punës për hartimin e akteve administrative.** Ka marrë pjesë në grupin e punës për përgatitjen dhe hartimin e Rregullores së Brendshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, sipas urdhrit Nr.12 datë 18.11.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Lushnjë. **Akti i përcaktuara në nën kriterin 2 bën që të përmbushet edhe ky nën kriter.**
61. **Për kriterin e dytë kandidati vlerësohet me kualifikim të mesëm, referuar nenit 15 të Rregullores.**

3. Kriteri i tretë “Aftësitë në ndërveprimin me median

62. Sa i takon kriterit të tretë “Aftësitë në ndërveprimin me median”, rezulton se **kandidati përmbush 3 nga nën kriteret.**
- a. **Nën kriteri 1. Eksperiencë e mëparshme si prokuror i caktuar për çështjet e shtypit.** Me Urdhrin nr. 28, datë 06.06.2022 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë

Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, është caktuar si prokuror i caktuar për çështjet e shtypit. **Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.**

- b. **Nën kriteri 2. Pjesëmarrje në çështje penale të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike.** Janë paraqitur aktet e dosjes penale si dhe printime artikujsh nga gazeta të ndryshme.
- i. Procedimi Nr.1262, për veprat penale të parashikuara nga nenet 100/2 dhe 79/a të K.Penal në ngarkim të të pandehurit K.Ç. Procedimi lidhet me ngjarjen e datës ku i pandehuri ka përdhunuar dhe më pas vrarë e gënjatur të miturin M.V. Prokurorja ka bërë përfaqësimin në gjykatë.
 - ii. Procedimi penal Nr.28 kundër të pandehurve: I.M, E.B, Y.N, F.B, etj për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 79 germa “dh” në lidhje me nenin 25 të K.Penal. Ky procedim lidhet me ngjarjen e datës 08.01.2016 në vendin e quajtur Mbrostar-Ura, në afërsi të fabrikës së miellit “Mulliri i Artë”, Fier, është qëlluar me armë zjarri në drejtim të automjetit me targë AA 414 LC, në të cilën udhëtonin për në drejtim të Fierit shtetasit K.K, B.K, E.M dhe D.K. Si pasojë e sulmit me armë zjarri ka mbetur i vrarë shtetasi D.K dhe janë plagosur dy shtetas. Kandidatja ka bërë me dije se për këtë çështje kanë shkruar edhe mediat ndërkombëtare. Është kërkuar në internet në lidhje me këtë fakt dhe është printuar një shkrim i gazete Britanike “Daily Mail” në lidhje me këtë çështje penale.
 - iii. Procedimi penal Nr.1006 datë 04.01.2017, regjistruar për veprat penale “Vrasja me dashje” dhe “Vjedhja”, të parashikuara nga nenet 76 dhe 134/1 të K.Penal në ngarkim të shtetasit A.Z. Ky procedim penal lidhet me ngjarjen e datës 22.06.2015 ku shtetasi A.Z ka vrarë në banesën ku jetonin së bashku, shtetasin K.B. Më pas, trupin e kishte prerë në copa dhe e kishte transportuar dhe hedhur në dalje të qytetit të Fierit.
 - iv. Procedimi penal nr. 106 datë 23.01.2018 kundër të pandehurit V.B, për kryerjen e veprës penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal dhe personave nën hetim Z.D, E.J, B.B dhe A.B të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 236/2 i K.Penal. Ky procedim penal lidhet me ngjarjen e datës 22.01.2018, ku në vendin e quajtur “Landfilli në ndërtim”, me vendndodhje midis fshatrave Verri dhe Kallm të Njësisë Administrative Mbrostar Ura, rrethi Fier, i pandehuri V.B, personat e tjerë nën hetim si dhe banorë të tjerë të zonës përreth, janë grumbulluar për të kundërshtuar ndërtimin e impiantit të përpunimit të mbeturinave, që po ndërtohet në këtë njësi administrative.
- c. **Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.**
- d. **Nën kriteri 3. Nuk ka marrë pjesë në trajnime afatgjata në fushën e marrëdhënieve me publikun.**



e. **Nën kriteri 4. Trajnime afatshkurtra në fushën e marrëdhënieve me publikun.**

Kandidatja ka dorëzuar:

- i. Certifikatë dhe kopje të Axhendës për pjesëmarrje në trajnimin me temë: “Komunikimi i krizave: Mediat Sociale, Fushata në shumë platforma mediatike”, organizuar nga WINPROO III, Tiranë, në datat 06-07 Dhjetor 2017.
- ii. Kandidatja ka dorëzuar komunikimin elektronik me Prokurorinë e Përgjithshme dhe kopje të Axhendës për pjesëmarrje në takimin ndërgjegjësues mbi të Drejtën e Informimit dhe Ndjekjen penale, organizuar nga Pameca V, në datë 17.10.2018 në Tiranë.
- iii. Kandidatja ka dorëzuar Axhendën për pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar në kuadër të një programi të përbashkët mes Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Për Forcimin e Efikasitetit dhe Cilësisë së sistemit gjyqësor në Shqipëri”. Ky aktivitet ka pasur për qëllim zhvillimin e një marrëdhënie sa më të mirë midis medias dhe zyrave të prokurorisë në Shqipëri dhe si të përdoren mjetet e CEPEJ (Komisioni i Efikasitetit të Drejtësisë së Këshillit të Evropës) si dhe praktikat më të mira evropiane për të forcuar efikasitetin e kësaj marrëdhënie. Ky aktivitet është zhvilluar në datat 14 dhe 15 Maj 2018 në Tiranë.
- iv. Kandidatja ka dorëzuar komunikimin elektronik dhe kopje të Axhendës për pjesëmarrje në trajnimin me temë: “Ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi me median, zhvilluar në datat 19-20 Nëntor 2018 nën kujdesin e Projektit IPA 2017 "Lufta kundër Krimeve të Rënda në Ballkanin perëndimor".

f. **Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.**

63. **Për kriterin e tretë kandidati vlerësohet me kualifikim të lartë, referuar nenit 15 të Rregullores.**

4. Kriteri i katërt “Aftësi të tjera”

64. Sa i takon kriterit të katërt “Aftësi të tjera”, rezulton se kandidati **përmbush 2 nga nën kriteret.**

a. **Nën kriteri 1. Aktivizim në struktura organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit.** Kandidatja ka sjellë dokumentacion si më poshtë:

- i. Ka qenë pjesë e grupit të Menaxhimit Strategjik (G.M.S.) i Njësisë Publike në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Fier sipas Urdhrit Nr.40 datë 20.07.2022 të drejtuesit të kësaj prokurorie.
 - ii. Ka qenë pjesë e Ekipit të Menaxhimit të Programeve Buxhetore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, sipas Urdhrit Nr.41 datë 20.07.2022 të Drejtuesit të Prokurorisë.
- b. Sa i takon këtyre dy grupeve të punës, ato konsiderohen, detyra dytësore në kuadër të detyrës që çdo nëpunës ushtron në Institucion. **Ky nën kriter nuk do të konsiderohet i përmbushur.**

SECRET

- c. *Nën kriteri 2. Nuk është aktivizuar si magjistrat udhëheqës për kandidatë prokurorë, si ekspert apo lehtësues në Shkollën e Magjistraturës.*
- d. *Nën kriteri 3. Mbajtja e gradës shkencore ose titujve akademik, studime dhe specializime afatgjata, zotërim i gjuhëve të huaja.*
- i. Kandidatja është pajisur me Certifikatë për ndjekjen e modulit të parë të kursit “*Specific English Training*”, për gjuhën angleze, organizuar nga Qendra e Gjuhëve të Huaja “*Universi*” dhe Prokuroria e Përgjithshme. Pajisur me certifikatë për ndjekjen e kursit të nivelit superior të gjuhës italiane me rezultat optimal, nga Instituti i Kulturës Italiane në Tiranë. ***Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.***
- e. *Nën kriteri 4. Aftësi e provuar për të punuar në grup dhe në mjedis multidisiplinare dhe/ose multikulturore.* Nga ana e kandidatës është paraqitur dokumentacion i ndryshëm që vërteton pjesëmarrjen në grupe pune, konsultë publike, trajnime dhe tryeza me ekspertë të huaj si më poshtë:
- i. Caktim në grupin hetimor në kuadër të procedimit penal Nr.1340 viti 2019 sipas Urdhrit Nr.99 datë 18.10.2019 të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Fier.
- ii. Caktim në grupin hetimor në kuadër të procedimit penal Nr.1371 viti 2017 sipas Urdhrit Nr.33 datë 03.06.2021 të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Fier.
- iii. Caktim në grupin hetimor në kuadër të procedimit penal Nr.338 viti 2012 sipas Urdhrit Nr.34 datë 03.06.2021 të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Fier.
- iv. Pjesëmarrje në procedurë ankandë sipas Urdhrit Nr.1 datë 23.09.2021 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Fier.
- v. Pjesëmarrje në cilësimin e përgjegjëses së Komisionit për Vlerësimin e kandidaturave për plotësimin e një vendi vakant në administratë, sipas Urdhrit Nr.32 datë 13.09.2022 ndryshuar me urdhrin Nr.32/1 prot datë 07.07.2022 të drejtuesit të Prokurorisë Fier.
- vi. Caktuar sipas Urdhrit nr.15 datë 10.02.2023 të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Fier, të prokurorit përgjegjës për ndjekjen e trajnimit fillestar për O.P.GJ K.B.
- vii. Pjesëmarrje në Njësinë e ankandit dhe vlerësimin e ofertave sipas Urdhrit Nr.1 datë 23.09.2021 të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Fier.
- viii. Pjesëmarrje në tryezën e rumbullakët me drejtuesit e NJPH dhe Ndërlidhësit e Posaçëm dhe Sesione Trajnuese me Agjentët e FBI për Teknikat e Hetimit me Agjentë të Infiltruar, organizuar nga Ambasada Amerikane, zhvilluar në Elbasan në datë 28 Prill 2015.
- ix. Pjesëmarrje në Konsultimin Publik mbi Reformën në Drejtësi “Edukimi ligjor dhe Profesionet e Lira”, organizuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë. Zhvilluar në 2 Korrik 2015, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.



- x. Pjesëmarrje në Konsultimin publik “Projektligjet për mirëqeverisjen, organizimin e gjyqësorit dhe statusin e magjistratit”. Organizuar nga Komisioni Parlamentar i Posaçëm për Reformën në Drejtësi. Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, në Vlorë në datë 17 maj 2016.
- xi. Pjesëmarrje në Tryezën Rajonale për ndryshimet në kodet procedurale në funksion të efikasitetit të proceseve gjyqësore, organizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Tiranë në datat 24-25 Korrik 2019.
- xii. Pjesëmarrje në kursin: “Mbrojtja e dëshmitarëve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit”, organizuar nga NI-CO dhe WINPROO III, Tiranë, 06-11 Nëntor 2017 ku është punuar në grupe.
- xiii. Pjesëmarrje në trajnimin teorik me temë “*Bashkëpunimi në Drejtësinë Penale, Forcimi i Mbrojtjes së Dëshmitarëve në luftën ndaj Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit*”. Organizuar nga Projekti WINPRO III, Podgoricë, Mal i Zi, në datat 02-05 Tetor 2018, ku është punuar në grup.
- xiv. Pjesëmarrje në trajnimin me temë “*Case simulation exercise on cybercrime and financial investigations*” organizuar nga IPROCEEDS, Tiranë, në datat 04 - 07 Mars 2019, ku është punuar në grup.
- xv. Pjesëmarrje në trajnimin mbi analizën strategjike, me përfaqësues nga Njësitë e Inteligjencës Financiare dhe Agjencitë Ligj zbatuese në Podgoricë, Mal i Zi, në datat 09-11 prill 2019. Në këtë trajnim është punuar në grupe të ndara në specialistë të fushave të ndryshme, përfaqësues të shteteve të ndryshme pjesëmarrëse.

f. ***Ky nën kriter konsiderohet i përmbushur.***

65. ***Për kriterin e katërt kandidati vlerësohet me kualifikim të mesëm, referuar nenit 15 të Rregullores.***

E. Vlerësimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

66. Theksojmë faktin se në momentin e aplikimit, nga ana e kandidatëve u paraqitën edhe platformat për drejtimin e zyrës, material ky që u vlerësua nga Këshilli në lidhje me kriterin e pestë “*Vizioni për ngritjen e një zyre prokurorie funksionale dhe efektive*”, pasi u realizuar intervistimi i kandidatëve.
67. Rezultati i nxjerrë nga analiza e dokumentacionit (*shkallët e vlerësimit*), për të tre kandidatët, është paraqitur nga Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për miratim në mbledhjen e datës 02.05.2023 sipas përcaktimeve të nenit 24 “*Shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projekt aktit të relatorit*” të Rregullores. Komisioni ka miratuar Relacionin me tre vota pro duke ja kaluar atë Mbledhjes Plenare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për miratim.
68. Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 99, datë 09.05.2023 “*Për miratimin e shkallës së vlerësimit të kriterëve të posaçme të kandidatëve për ngritjen në detyrë në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier*”, ka miratuar shkallët e vlerësimit siç janë propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës si më poshtë :



KOMPONENTËT E VLERËSIMIT TË AFTËSIVE SIPAS SHKALLËVE				
Kandidati	Aftësitë e organizimit në punë dhe drejtimi	Aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore	Aftësitë në ndërveprimin me median	Aftësi të tjera
Elida Hoxhaj	<i>Nivel i mesëm</i>	<i>Nivel i mesëm</i>	<i>Nivel i lartë</i>	<i>Nivel i ulët</i>
Elion Mustafaj	<i>Nivel i lartë</i>	<i>Nivel i mesëm</i>	<i>Nivel i lartë</i>	<i>Nivel i mesëm</i>
Suela Beluli	<i>Nivel i mesëm</i>	<i>Nivel i mesëm</i>	<i>Nivel i lartë</i>	<i>Nivel i mesëm</i>

69. Mbas miratimit të shkallëve të vlerësimit, Këshilli ka njoftuar kandidatët për seancën dëgjimore (*intervista*) dhe prezantimin e platformës së tyre dhe arsyeve të kandidimit, që u mbajt më datë 22.05.2023.
70. Në mbledhjen e datës 22.05.2023, Këshilli intervistoi kandidatët, sipas rendit alfabetik, ku e para është intervistuar Znj. Hoxhaj, i dyti Z. Mustafaj dhe e treta Znj. Beluli. Mbas parashtrimit të platformave respektive dhe arsyeve të kandidimit, Anëtarët e Këshillit ju kanë drejtuar pyetje të tre kandidatëve.
71. Mbas përfundimit të seancës dëgjimore me kandidatët, Këshilli në pjesën e dytë të seancës plenare e cila është zhvilluar të nesërmen më datë 23.05.2023, ka kaluar në pikëzimin e kandidatëve sipas Aneksit 1 të Rregullores, për katër kritere dhe shkallët respektive të miratuara më parë si dhe për kriterin e pestë që lidhet me vizionin për ngritjen e një zyre prokurorie funksionale dhe efektive. Konkretisht mënyra e pikëzimit për katër kriteret jepet në pikën 4 të nenit 15 “Niveli dhe pikëzimi” të Rregullores, si më poshtë: “Për nivelin e vlerësimit të lartë do të aplikohen nga 8 deri në 10 pikë, për nivelin e vlerësimit të mesëm do të aplikohen nga 4 deri në 7 pikë dhe për nivelin e vlerësimit të ulët do të aplikohen nga 0 deri në 3 pikë, sipas Aneksit nr.1.”
72. Sa i takon kriterit të pestë “Vizioni për ngritjen e një zyre prokurorie funksionale dhe efektive”, i Aneksit 1 të Rregullores, ai përbëhet nga 3 nën kritere, me pikët respektive, si më poshtë :
- a. *Plan i detajuar mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave të drejtuesit, gjatë ushtrimit të ndjekjes penale. (1 deri në 4 pikë)*
 - b. *Plan i besueshëm në lidhje me mënyrën e organizimit dhe funksionimit së zyrës së prokurorisë, për veprimtarinë administrative që lidhet me ushtrimin e ndjekjes penale. (1 deri në 3 pikë)*
 - c. *Plan i besueshëm dhe shumë i detajuar për të drejtuar zyrën, për të zhvilluar funksionimin dhe efektivitetin e saj në aspektin administrativ dhe përfaqësimi në marrëdhënie me të tretët. (1 deri në 3 pikë)*

73. Ky pikëzim lidhet me paraqitjen e kandidatit në seancë dëgjimore si dhe me platformën e paraqitur nga ana e tyre.
74. Sa i takon pikëzimit që secili nga anëtarët ka bërë, vlerësojmë se e drejta për ngritjen në detyrë në pozicionin e Drejtuesit, është një e drejtë ekskluzive e Këshillit, dhënë nga Kushtetua e Republikës së Shqipërisë mbi bazën e neneve 149 dhe 149/a të saj, si dhe nga ligji nr. 96/2016 e aktet nën ligjore dalë në zbatim të tij.
75. Secili prej anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke mbajtur parasysh konfigurimin strukturor të Këshillit, *(i cili përbëhet nga 6 prokurorë përfaqësues të të gjitha niveleve të prokurorisë dhe 5 jo prokurorë nga radhët e avokatëve, pedagogëve dhe shoqërisë civile)* vendos mbi bazën e bindjes së tij të brendshme, e cila pashmangshmërisht lidhet me këndvështrimin e secilit anëtar mbi interpretimin e ligjit dhe situatave konkrete. Kjo bindje e brendshme ndikohet gjithashtu edhe nga këndvështrimi i grupit të interesit *(kupto grupin nga është zgjedhur)* të cilin secili anëtar përfaqëson.
76. Sa më sipër ushtrim i diskrecionit të anëtarëve të Këshillit në pikëzimin e kandidatëve është një e drejtë ekskluzive te tyre e parashikuar në Kushtetutë dhe ligj.
77. Nga pikëzimi rezultoi si më poshtë :

VLERËSIMI ME PIKË SIPAS ANËTARËVE TË KËSHILLIT													TOT
NR.	KANDIDATI	ALFRED BALLA	MIRELA BOGDANI	BUJAR SHESHI	SOKOL STOJANI	ESMERALDA KESHI	ELOIDA GOXHI	ZEQIR HODA	NURIHAN SEITI	TARTAR BAZAJ	LEDINA RIZA	ARTA MANDRO	
1.	ELIDA HOXHAI	34	30	26	30	32	28	34	37	30	34	34	349
2.	ELION MUSTAJ	36	42	44	44	44	44	41	27	44	41	43	450
3.	SUELA BELULI	36	30	35	32	36	36	41	41	41	39	38	405

78. Sa më sipër, në përfundim të vlerësimit krahasimor, kandidatët të cilët kanë nivel të njëjtë vlerësimi etiko-profesional dhe për të cilët është kaluar në vlerësimin e posaçëm, renditen me pikë si vijon:
- Elion Mustafaj 450 pikë
 - Suela Beluli 405 pikë
 - Elida Hoxhaj 349 pikë



79. Sa i takon kandidatit Genci Mane, ai do të renditet i katërti për shkak se dy vlerësimet e fundit etiko profesionale i ka “mirë”.
80. Në përfundim, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenin 52, pika 10 të ligjit Nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar, dhe në nenin 27 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”,

V E N D O S I:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve për pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier si më poshtë;
 - i. Elion Mustafaj
 - ii. Suela Beluli
 - iii. Elida Hoxhaj
 - iv. Genci Mane
2. Të njoftojë të gjithë kandidatët për këtë Vendim.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e njoftimit të Vendimit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 23.05.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ZY/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Eloida Coxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza